

LIGJ
Nr.8331, datë 21.4.1998

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE¹

(Ndryshuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008, nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

I përditësuar

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe në vijim të nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU I
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

(Shfuqizuar paragrafi i dytë me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008; ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Ky ligj ka për objekt vënien në ekzekutim të vendimeve gjyqësore penale dhe urdhërimeve të tjera ligjore, ndaj të dënuarve, si dhe përcaktimin e mënyrës së vuajtjes së dënimeve dhe të dënimeve alternative, me përjashtim të dënimit me burgim. Mënyra e vuajtjes së dënimit me burgim rregullohet me ligj të posaçëm.

Sipas këtij ligji ekzekutohen edhe vendimet e gjykatës lidhur me masat e sigurimit për aq sa nuk përcaktohet ndryshe nga Kodi i Procedurës Penale.

Neni 2

Kuptimi i ekzekutimit

(ndryshuar titulli me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Me ekzekutim të vendimit penal kuptohet zbatimi i urdhërimeve që përmban vendimi penal i formës së prerë dhe i vendimeve që, sipas Kodit të Procedurës Penale, kanë ekzekutim të menjëhershëm, me synimin e riedukimit të të dënuarve, të rivendosjes së të drejtave të personave të proceduar padrejtësisht dhe të drejtave të subjekteve juridike të cenuara nga vepra penale, duke ndikuar në parandalimin e tyre.

Neni 3

Të drejtat e të dënuarit

¹ Ligji nr.8331, datë 21.4.1998 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 12.

Ligji nr.10 024, datë 27.11.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 190, datë 31 dhjetor 2008.

Ligji nr. 80/2018, datë 15.11.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 172, datë 5 dhjetor 2018.

Ekzekutimi i vendimeve që përmbajnë dënim, kufizon vetëm ato të drejta, në atë masë dhe kohë, sa përcakton vendimi penal, duke respektuar të gjitha të drejtat e tjera të njohura ligjshëm, përveç rasteve të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj.

Personi i dënuar në të gjitha fazat e ekzekutimit të vendimit, gëzon të drejtat që i takojnë sipas këtij ligji dhe, kur nuk i njihen ose i cenohen ato, kërkon mbrojtjen dhe realizimin e tyre në mënyrën që përcaktohet në këtë ligj.

Neni 4

Parimi i barazisë

(ndryshuar me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Zbatimi i dispozitave të këtij ligji sigurohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë personat nën hetim, të pandehur dhe të dënuar, pa diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër.

Neni 5

Trajtimi i të miturve dhe i grave

(ndryshuar me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Ekzekutimi i vendimeve për të miturit bëhet në përputhje me rregullat procedurale të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, Kodin e Procedurës Penale dhe nga ky ligj, për aq sa parashikimet e këtij ligji nuk bien ndesh me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Ekzekutimi i vendimeve penale për gratë kryhet duke pasur parasysh mbrojtjen e dinjitetit, nevojat e tyre fizike, sociale, profesionale, shëndetësore dhe psikologjike.

Neni 6

Parimi i zbatimit vullnetar

Vendimet penale vihen në ekzekutim vullnetarisht nga i dënuari në mënyrën, kohën dhe vendin e caktuar nga organi kompetent sipas këtij ligji. Vetëm në rast refuzimi të zbatimit vullnetar të tyre, bëhet ekzekutimi i detyrueshëm.

Neni 7

Mbrojtja e të drejtave

Për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të tij, të dënuarit i garantohet komunikimi me organet kompetente, ankimi në gjykatë dhe mbrojtja me avokat.

Mbrojtësi, mbi kërkesën e të dënuarit ose kur e çmon, ka të drejtë të marrë takim me të dënuarin, duke respektuar rregullat përkatëse, të kërkojë sqarime, të marrë informacionet e nevojshme, t'u kërkojë organeve të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit, marrjen e masave në kompetencë të tyre, të kërkojë ndërhyrjen e prokurorit, kur ka pengesa dhe t'i paraqesë kërkesa gjykatës për çështje në kompetencë të saj.

Neni 8

Përgjegjësia e organeve të ekzekutimit

Organet dhe punonjësit që ekzekutojnë vendimet sipas këtij ligji, janë të detyruar të ushtrorjnë me korrektësi kompetencat, duke respektuar të drejtat, nderin dhe dinjitetin e personit.

Personat e ngarkuar për ekzekutimin e vendimit penal mbajnë përgjegjësi disiplinore dhe, kur është rasti, edhe penale, për mosvënien, zvarritjen ose ekzekutimin e vendimit në kundërshtim me ligjin apo të drejtat e personit.

Neni 9 **Prokurori**

Prokurori është i detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e këtij ligji, të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit, të ndërhyjë në organet kompetente ose të paraqesë kërkesë në gjykatë për rivendosjen e ligjit e të së drejtës së shkelur dhe vënien e shkaktarëve para përgjegjësisë sipas ligjit.

Neni 10 **Detyrimi për njoftimin e fakteve dhe rrethanave**

Mosnjoftimi i prokurorit për fakte dhe rrethana që ndikojnë në mënyrën dhe kohën e ekzekutimit të një vendimi penal, kur nuk ka vend për përgjegjësi penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë deri në 100 mijë lekë.

Me kërkesën e prokurorit çështja shqyrtohet nga gjykata duke respektuar kriteret e ligjit “Për kundërvajtjet administrative”.

Me marrjen në dijeni të fakteve e rrethanave të reja, prokurori pasi bën verifikimin, sipas rastit, ndërhyr sipas këtij ligji ose paraqet kërkesë në gjykatën kompetente.

Kur fakti ose rrethana ndikon në bazueshmërinë ose ligjshmërinë e vendimit, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.

PJESA II VËNIA NË EKZEKUTIM E VENDIMEVE PENALE

KREU I KOMPETENCAT PËR VËNIEN NË EKZEKUTIM

Neni 11 **Gjykata**

Për vendimet penale me ekzekutim të menjëhershëm urdhërimet i jep gjykata që ka dhënë vendimin menjëherë pas shpalljes së tij.

Neni 12 **Prokurori**

Prokurori është organi që vë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të të gjithë vendimeve të tjera penale dhe në mbështetje të neneve 463 dhe 468 të Kodit të Procedurës Penale, procedon vetë ose urdhëron organet e tjera për vënien në ekzekutim të vendimit sipas Kodit të Procedurës Penale, sipas këtij ligji dhe dispozitave të tjera ligjore.

Prokurori mban evidencë të veçantë për vendimet në ekzekutim dhe për të gjitha faktet e ndodhura gjatë ekzekutimit.

Neni 13

Urdhri i ekzekutimit

(ndryshuar me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Urdhri i ekzekutimit është akti procedural, mbi bazën e të cilit prokurori kryen procedurën e ekzekutimit të vendimit penal.

Urdhri i ekzekutimit përmban:

a) Numrin, datën, gjykatën që ka dhënë vendimin, përmbajtjen e plotë të dispozitivit të vendimit penal objekt ekzekutimi dhe disponimet e nevojshme për ekzekutimin;

b) Gjenealitetet e personit ndaj të cilit do të ekzekutohet vendimi penal, adresën e vendbanimit ose të vendqëndrimit, pranë së cilës do të kryhet njoftimi i urdhrit të ekzekutimit;

c) Llojin dhe masën e dënimit kryesor, si dhe kohëzgjatjen tërësore të vuajtjes së dënimit, kur kjo duhet përlllogaritur nga prokurori, sipas procedurave të parashikuara në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe rregullave të parashikuara në këtë ligj;

ç) Llojin e dënimit plotësues dhe kriteret e zbatimit të tij;

d) Në rastet e dënimit me burgim, llojin e sigurisë që duhet të ketë vendi i vuajtjes së dënimit, sipas përcaktimit të bërë nga gjykata në dispozitivin e vendimit penal kryesisht ose bazuar në kërkesën e prokurorit për përcaktimin e llojit të sigurisë, sipas nenit 22 të këtij ligji;

dh) Detyrimin civil në procesin penal;

e) Organet që ekzekutojnë ose mbikëqyrin ekzekutimin e vendimit;

ë) Detyrimin e organeve që ekzekutojnë ose mbikëqyrin ekzekutimin e vendimit për njoftimin e zbatimit të urdhrit të ekzekutimit. Në rastin e të dënuarve të mitur ose me aftësi të kufizuara përcaktohet edhe mënyra e njoftimit të urdhrit të ekzekutimit.

Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit, si dhe prokurorët, që kanë marrë pjesë në gjykim pranë gjykatës së apelit apo Gjykatës së Lartë, menjëherë pas administrimit, i paraqesin zyrtarisht dispozitivin e vendimit penal prokurorisë përkatëse të shkallës së parë që ka përgjegjësinë e ekzekutimit të vendimit.

Urdhri i ekzekutimit nxirret nga prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin e dënimit. Në rastin e të miturve, urdhri i ekzekutimit nxirret nga prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë, në të cilën është ngritur seksioni për të mitur.

Neni 14

Njoftimi i mbrojtësit dhe i të dënuarit të mitur

(ndryshuar me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Urdhri i ekzekutimit i njoftohet menjëherë dhe jo më vonë se 30 ditë mbrojtësit të të dënuarit dhe, kur nuk ka të tillë, mbrojtësit të caktuar nga prokurori.

Njoftimi i urdhrit të ekzekutimit për të dënuarit e mitur bëhet në mënyrë të tillë që informacioni të jetë i përshtatshëm dhe i kuptueshëm për ta, duke mbajtur në konsideratë nevojat e tyre në rastet e aftësisë së kufizuar. Organet e ekzekutimit njoftojnë paraprakisht edhe përfaqësuesin ligjor/ procedural ose një person tjetër të rritur të treguar dhe pranuar prej tij, si dhe psikologun apo punonjësit e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës, kur rasti është trajtuar nga këto të fundit.

Për të dënuarit me fëmijë të mitur, organi i ekzekutimit njofton bashkëshortin e padënuar dhe, kur nuk ka ose nuk dihet ku ndodhet, Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës së vendbanimit të të dënuarit.

Neni 15

Viktima e veprës penale

(ndryshuar me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Viktima e veprës penale, së cilës i është njohur e drejta për shpërblimin e dëmit me vendim gjyqësor të formës së prerë, kërkon vënie në ekzekutim të vendimit që përmban urdhërime në favor të tij, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

Urdhërimet e vendimit penal, lidhur me të drejta pasurore në favor të shtetit, ekzekutohen sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

Prokurori ka të drejtë të informohet në çdo kohë për ekzekutimin e të drejtave pasurore shtetërore që rrjedhin nga një vendim penal.

Kur prokurori konstaton se organi kompetent shtetëror nuk merr masa, i drejtohet gjykatës për të kërkuar vënien në ekzekutim të të drejtave pasurore që rrjedhin nga vendimi penal, bazuar në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile.

KREU II ORGANET QË EKZEKUTOJNË VENDIMIN PENAL TË FORMËS SË PRERË

Neni 16

Detyrat e Policisë së Shtetit

(Ndryshuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008)

Policia e Shtetit, mbi bazën e urdhrit të prokurorit, në bashkëpunim me Policinë Gjyqësore dhe Policinë Ushtarake, kryen veprimet për ekzekutimin vullnetar të dënimit me burgim, në të kundërtën, vepron forcërisht duke vënë të dënuarin në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Dënimet plotësuese parashikuar nga pikat 3, 7 dhe 8 të nenit 30 të Kodit Penal ekzekutohen nga vetë Policia e Shtetit.

Policia e Shtetit, në bazë të një kërkesë ose me nismën e vet, mbështet veprimet e policisë gjyqësore, të policisë ushtarake, policisë së burgjeve dhe të organeve të tjera përkatëse, të ngarkuara, sipas këtij ligji, për ekzekutimin e vendimeve penale, që kanë marrë formë të prerë apo që kanë ekzekutim të menjëhershëm.

Neni 17

Ekzekutimi nga shërbimi i përmbarimit gjyqësor

(Ndryshuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008)

Shërbimi i përmbarimit gjyqësor ekzekuton dënimin me gjobë, dënimet plotësuese, të parashikuara në pikën 2 të nenit 30 të Kodit Penal, shpenzimet gjyqësore dhe detyrimin civil, të caktuar në vendimin penal.

Neni 18

Organet shtetërore dhe subjektet juridike

Vendimet që përmbajnë dënime plotësuese të parashikuara nga pikat 1, 4 dhe 6 të nenit 30 të Kodit Penal ekzekutohen nga organet përkatëse shtetërore ose personat e tjerë juridikë shtetërorë ose privatë mbi bazën e urdhrit të ekzekutimit.

Neni 19

Ekzekutimi nga i dënuari

Dënimi plotësues parashikuar nga pika 9 e nenit 30 të Kodit Penal ekzekutohet nga vetë i dënuari sipas urdhërimit të gjykatës.

Në rast mosveprimi prej tij, vendimi ekzekutohet nga prokurori me shpenzimet e të dënuarit.

Neni 20

Njoftimet gjatë ekzekutimit

Organet kompetente për ekzekutimin e vendimeve penale njoftojnë prokurorin për fillimin dhe përfundimin e ekzekutimit të vendimeve.

I dënuari i paraqet prokurorit vërtetimin e organit që ka bërë publikimin e vendimit.

Kur kërkohet, në bazë të këtij ligji ose me dispozita të veçanta, bëhen njoftime periodike edhe gjatë ekzekutimit.

Prokurori për fillimin e ekzekutimit dhe përfundimin e tij njofton gjykatën.

PJESA III MËNYRAT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

KREU I EKZEKUTIMI I VENDIMEVE QË NUK KANË MARRË FORMË TË PRERË

Neni 21

Ekzekutimi i menjëhershëm

(shtuar fjalë në pikën 1 dhe ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Ekzekutohen me urdhër të gjykatës menjëherë pas shpalljes së vendimit:

1. Vendimet penale që përmbajnë pafajësi, përjashtimin e të gjykuarit nga dënimi ose pushimin e gjykimin të çështjes sipas pikës 2 të nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe kur gjendet i paligjshëm arresti në flagrancë ose ndalimi, duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm, përveç kur ka një masë sigurim me arrest për shkak tjetër, si dhe pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë.

2. Për ekzekutimin e menjëhershëm, gjykata i njofton menjëherë prokurorit shkurtimin e vendimit. Prokurori nxjerr urdhrin e lirimit të menjëhershëm, i cili vihet në ekzekutim nga organet përgjegjëse, pasi të kenë verifikuar më parë që ndaj të njëjtit person ose së njëjtës pasuri nuk janë në fuqi vendime të tjera penale që legjitimojnë vazhdimin e mbajtjes së personit nën arrest, ndalim, paraburgim ose burgim apo mbajtjes së pasurisë nën sekuestro ose konfiskim.

3. Vendimi penal që përmban burgim dhe miratim të kërkesës së prokurorit për masën e sigurimit me arrest.

4. Vendimet penale që përmbajnë sekuestrim si masë provizore kur jepet një dënim me konfiskim.

Për ekzekutimin e menjëhershëm, gjykata i jep paraprakisht organit përkatës urdhrin me shkrim dhe brenda 3 ditëve nga shpallja i dërgon vendimin penal.

KREU II EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË FORMËS SË PRERË DHE I DËNIMEVE ALTERNATIVE

(Ndryshuar titulli me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008)

Neni 22

Veprimet paraprake të prokurorit

Vendimet me burgim, me marrjen formë të prerë, i dërgohen prokurorit nga gjykata menjëherë ose tërhiqen prej tij për vënien në ekzekutim.

Kur vendimi i gjykatës nuk e përcakton dhe prokurori konstaton se është vendi për vuajtjen e dënimit në burgun e sigurisë së lartë, i paraqet kërkesë gjykatës që ka dhënë vendimin.

Kur i dënuari ka qenë i paraburgosur, në urdhrin e ekzekutimit saktësohen koha e vuajtur dhe pjesa që mbetet për të vuajtur sipas kritereve të nenit 57 të Kodit Penal.

Kur i dënuari ka për të vuajtur më shumë se një dënim, prokurori i paraqet kërkesë gjykatës për bashkimin e dënimeve.

Mbi bazën e vendimit të gjykatës dhe kritereve të ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, prokurori përcakton llojin e institucionit ku i dënuari do të vuajë dënimin dhe nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve saktëson institucionin konkret.

Kur gjykata nuk e ka konstatuar dhe prokurori ka të dhëna se është vendi për vendosjen në institucione të veçanta, ai urdhëron kontrollin mjekësor të të dënuarve dhe vepron sipas rezultateve.

Neni 23

Nxjerrja dhe dërgimi i urdhrin të ekzekutimit

Mbi bazën e vendimit të gjykatës dhe të veprimeve sipas nenit 22 të këtij ligji, prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit dhe ia dërgon Policisë së Shtetit të vendit ku ka vendbanimin, qëndrimin e përhershëm ose vendqëndrimin e të dënuarit.

Për të dënuarit ushtarakë urdhri i dërgohet policisë ushtarake pranë repartit ku ka qenë efektiv i dënuari ose të vendit ku ai ndodhet.

Kur i dënuari është i paraburgosur urdhri i dërgohet organit ku ai mbahet.

Kur vendbanimi i përhershëm nuk dihet, urdhri i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të Ministrisë përgjegjëse për rendin publik.

Neni 24

Njoftimi për ekzekutim vullnetar

(ndryshuar me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Punonjësi i Policisë së Shtetit, punonjësi i Policisë Ushtarake, për të dënuarit ushtarakë, ose Shërbimi i Provës, i ngarkuar për zbatimin e urdhrin të ekzekutimit, njofton të dënuarin, duke i caktuar kohën dhe vendin e paraqitjes vullnetare, me paralajmërimin se në rast të mosparaqitjes vullnetare, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të detyruar.

Për të dënuarin me burgim, ose me një nga alternativat e dënimit me burgim, i cili ka qenë në gjendje të lirë, ose në ngarkim të të cilit gjatë fazës së hetimit dhe gjykimit ka pasur një masë sigurimi të ndryshme nga masa e sigurimit “arrest në burg”, njoftimi kryhet në vendbanimin ose vendqëndrimin e të dënuarit. Për këtë qëllim mbahet procesverbal, i cili i dorëzohet të dënuarit personalisht dhe, kur kjo nuk është e mundur, familjarëve të tij. Kur kjo mënyrë njoftimi nuk është e mundur, njoftimi bëhet nëpërmjet strukturave vendore të Policisë së Shtetit ku i dënuari ka vendbanimin.

Njoftimi për ekzekutimin vullnetar të dënimit me burgim përmban:

- a) Numrin dhe datën e urdhrin të ekzekutimit të prokurorit;
- b) Numrin dhe datën e vendimit penal;
- c) Llojin dhe masën e dënimit të përllëgoar nga prokurori në urdhrin e ekzekutimit;
- ç) Datën, orën dhe vendndodhjen e institucionit ku i dënuari duhet të paraqitet vullnetarisht për të vuajtur dënimin;

d) Paralajmërimin se në rast mosparaqitje vullnetare në datën dhe orën e caktuar, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të detyruar.

Afati i paraqitjes vullnetare në institucionet e caktuara për vuajtjen e dënimit nuk mund të jetë më vonë se 7 ditë nga dita e njoftimit.

Vendimi gjyqësor për vendosjen e mbikëqyrjes elektronike i dërgohet menjëherë prokurorit, Shërbimit të Provës dhe Policisë së Shtetit, të cilët bashkëpunojnë për ekzekutimin e vendimit dhe monitorimin e zbatimit të tij.

Neni 25
Ekzekutimi i detyrueshëm

Kur i dënuari nuk paraqitet në ditën dhe vendin e caktuar, bëhet ekzekutimi i detyruar.

Me miratim të prokurorit ekzekutimi i detyrueshëm zbatohet drejtpërdrejt, kur ka arsye të mendohet se i dënuari mund t'i shmanget ekzekutimit ose në interes të sigurimit të rendit e të qetësisë publike.

Ekzekutimi i detyruar realizohet duke dërguar forcërisht të dënuarin në vendin e caktuar për vuajtjen e dënimit. Përpara përdorimit të forcës ose mjeteve shtrënguese ftohet gojarisht për ekzekutim vullnetar.

Forca fizike dhe mjetet shtrënguese përdoren në masën që u përgjigjen kundërveprimeve të të dënuarit dhe synojnë paralizimin e veprimeve dhe jo ndëshkimin e tij.

Lloji i mjeteve shtrënguese përcaktohet sipas dispozitave që të rregullojnë veprimtarinë e organit që ekzekuton vendimin.

Për përdorimin e forcës fizike dhe mjeteve të shtrëngimit gjatë ekzekutimit të detyruar njoftohet prokurori menjëherë pas kryerjes së veprimit.

Ekzekutimi i detyruar forcërisht zbatohet vetëm për dënimet me burgim dhe për dënimet plotësuese të parashikuara nga pikat 2 dhe 8 të nenit 30 të Kodit Penal.

Për të gjitha llojet e dënimeve të tjera, në rast mosparaqitjeje ose shmangie nga ekzekutimi, prokurori paraqet kërkesë për ndryshimin e llojit të dënimit sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 26
Dërgimi në vendin e vuajtjes së dënimit

Me paraqitjen vullnetare të të dënuarit ose me marrjen e tij forcërisht, organi i ngarkuar e shoqëron atë në institucionin e caktuar të vuajtjes së dënimit.

Mënyra e vuajtjes së dënimit me burgim dhe të drejtat e të dënuarit rregullohen sipas ligjit “Për trajtimin e të dënuarve me burgim”.

Neni 27

Kërkimi

Kur i dënuari nuk gjendet ose është larguar në drejtim të paditur, prokurori kryen veprimet e parashikuara në nenin 247 të Kodit të Procedurës Penale dhe, kur është rasti, edhe ato të nenit 504 të atij Kodi.

Neni 28

Lirimi i të burgosurit

(Ndryshuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008)

Dënimi me burgim vlerësohet i plotësuar dhe i dënuari lirohet kur:

- a) përfundon vuajtjen e dënimit;
- b) i falet dënimi i mbetur;
- c) amnistohet vepra penale apo dënimi i mbetur;
- ç) përfitohet plotësisht nga shfuqizimi apo ndryshimi i një dispozite penale, për të cilën është dënuar;
- d) lirohet me vendim gjykate.

I dënuari nuk lirohet kur ndaj tij ka filluar një procedim penal dhe është vendosur një masë sigurimi me arrest për një vepër tjetër penale, nga ajo për të cilën po vuan dënimin.

Kur personi i dënuar lirohet, sipas parashikimeve të shkronjave “a”, “b” dhe “c” të këtij neni, procedura e lirimit kryhet nga institucioni i ekzekutimit të vendimit penal, ndërsa në rastet e tjera lirimi bëhet me urdhër ekzekutimi të prokurorit.

Neni 29

Ekzekutimi i vendimit në gjysmëliri

(Ndryshuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008, shtuar fjalë në paragrafin e parë me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Kur gjykata vendos ekzekutimin e vendimit me burgim në gjysmëliri, parashikuar në nenin 58 të Kodit Penal, ia dërgon menjëherë shkurtimin e vendimit prokurorit për ekzekutim.

Administrata e burgjeve dhe shërbimi i provës, në bazë të vendit të kryerjes së detyrimeve nga personi i dënuar, përcakton institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri, bazuar në detyrimet që ai duhet të përmbushë.

Shërbimi i provës harton programin ditor, që duhet të zbatojë personi i dënuar për periudhën kohore, që ai ndodhet jashtë institucionit.

Neni 30

(Ndryshuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008, ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Shërbimi i provës mbikëqyr personin e dënuar me gjysmëliri, kur ndodhet jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

Shërbimi i provës i raporton menjëherë prokurorit dhe, kur është e nevojshme, edhe drejtorit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, kur personi i dënuar me gjysmëliri nuk përmbush kushtet ose detyrimet e tij për qëllimin e këtij dënimi.

Kur personi i dënuar me gjysmëliri nuk kthehet në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, drejtuesi i institucionit, pasi të ketë verifikuar faktet dhe rrethanat për moskthimin e tij, njofton menjëherë prokurorin dhe Shërbimin e Provës. Shërbimi i Provës, pasi verifikon faktet dhe rrethanat, përgatit raport vlerësimi për gjykatën dhe prokurorin.

Neni 31

Ekzekutimi i vendimit me punë me interes publik

(Ndryshuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008; shtuar fjalë në paragrafin e parë me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Kur gjykata vendos pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe, me pëlqimin e të dënuarit, zëvendësimin e tij me detyrimin për kryerjen e një pune të papaguar me interes publik, parashikuar në nenin 63 të Kodit Penal, ia dërgon menjëherë shkurtimin e vendimit përkatës prokurorit për ekzekutimin e dënimit alternativ.

Shërbimi i provës, duke pasur parasysh aftësitë dhe formimin profesional të personit të dënuar, harton dhe zhvillon një program për kryerjen e punës me interes publik.

Para fillimit të kryerjes së punës me interes publik, shërbimi i provës, në bashkëpunim me subjektin, pranë të cilit do të kryhet puna, i bëjnë të ditur personit të dënuar rregullat e sigurimit teknik në punë. Shërbimi i provës informon personin e dënuar për detyrimin e tij, për të mbajtur kontakte dhe për të përmbushur udhëzimet e dhëna nga ky shërbim.

Shërbimi i provës përcakton listën e institucioneve/shoqërive, publike apo private, ku mund të kryhet puna me interes publik.

Neni 31/1

Kontaktet me shërbimin e provës gjatë kryerjes së punës me interes publik

(Shtuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008)

Gjykata, me marrjen e vendimit për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit dhe zëvendësimin e tij me detyrimin për kryerjen e një pune me interes publik, urdhëron personin e dënuar të mbajë kontakte me shërbimin e provës.

Shërbimi i provës mbikëqyr të dënuarin, që kryen punë me interes publik.

Shërbimi i provës i raporton menjëherë prokurorit, kur personi i dënuar nuk mban kontakte me këtë shërbim apo nuk përmbush detyrimin e vendosur.

Neni 31/2

Moskryerja e punës

(Shtuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008)

Kur i dënuari nuk e kryen punën në mënyrë të rregullt, subjekti, pranë të cilit kryhet puna me interes publik, njofton menjëherë shërbimin e provës.

Me moskryerje të punës në mënyrë të rregullt nënkuptohet paraqitja me vonesë e mungesat pa arsye në punë apo mosrespektimi i rregullave për kryerjen, sjelljen dhe rendimentin në punë.

Neni 31/3

Pezullimi i vendimit për punë me interes publik

(Shtuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008)

Ekzekutimi i vendimit për punë me interes publik mund të pezullohet për shkak:

a) të sëmundjes së papritur të personit të dënuar, për të cilën është i nevojshëm trajtimi mjekësor dhe e pengon atë të kryejë punën;

b) të vdekjes së një anëtarit të familjes, si pasojë e së cilës personi i dënuar duhet të veprojë si kujdestar për anëtarët e tjerë të familjes dhe e pengon atë për kryerjen e punës;

c) të rrethanave të tjera të jashtëzakonshme, të cilat kërkojnë praninë e vazhdueshme të të dënuarit dhe e pengojnë atë të kryejë punën.

Personi i dënuar paraqet te prokurori kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të urdhrit për punën me interes publik. Shërbimi i provës verifikon ndryshimin e situatës, për të cilën i raporton prokurorit.

Detyrimi për të kryer punë me interes publik pezullohet deri kur gjykata të japë vendimin për kërkesën e paraqitur.

Gjykata, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës, merr vendimin për pezullimin e ekzekutimit të urdhrit për punë me interes publik, të cilin ia dërgon menjëherë prokurorit. Në vendim gjykata përcakton periudhën kohore të pezullimit.

Neni 31/4

Ekzekutimi i vendimit me qëndrim në shtëpi

(Shtuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008; ndryshuar paragrafi 2 dhe shtuar 4 paragrafë me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Kur gjykata vendos vuajtjen e dënimit të dhënë, me qëndrim në shtëpi, parashikuar në shkronjën “a” të nenit 59 të Kodit Penal, ia dërgon menjëherë për ekzekutim vendimin prokurorit dhe, në rast se ai mbahet në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale,

edhe drejtorisë së këtij institucioni.

Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të dënimit me qëndrim në shtëpi, në mënyrë të vazhdueshme, deri në vuajtjen e plotë të dënimit dhe bashkëpunon, sipas rastit, me strukturat përgjegjëse të njësive të vetëqeverisjes vendore, shërbimet sociale, organet vendore të Policisë së Shtetit, si dhe subjekte të tjera, private ose shtetërore.

Kur personi i dënuar me vendim me qëndrim në shtëpi synon të ndryshojë vendbanimin, duhet t'i drejtohet gjykatës, duke paraqitur dokumentacionin përkatës, që vërteton ndryshimin e vendbanimit.

Në këtë rast gjykata vendos për pranimin ose rrëzimin e kërkesës pasi merr më parë mendimin e Shërbimit të Provës.

Shërbimi i Provës, në rastet kur gjykata pranon kërkesën për ndryshimin e vendbanimit, zbaton masat e përcaktuara në këtë vendim dhe ia përcjell praktikën e ekzekutimit për të dënuarin zyrës përkatëse vendore të Shërbimit të Provës, ku i dënuari ka vendbanimin e ri.

Shërbimi i Provës njofton në lidhje me ndryshimin e vendbanimit organet vendore të Policisë së Shtetit, si dhe prokurorin që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit.

Shërbimi i provës siguron informacionin dhe asistencën e nevojshme për personin e dënuar nga institucionet shëndetësore, institucionet e ndihmës sociale, si dhe organizatat joqeveritare që bashkëpunojnë me të për zbatimin e vendimit me qëndrim në shtëpi.

Shërbimi i provës harton programe për personin, që vuan dënimin me qëndrim në shtëpi.

Kur personi i dënuar nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e vendosura nga gjykata, për shkak të ndryshimit të rrethanave, shërbimi i provës i rishikon këto detyrime, për të cilat i raporton menjëherë prokurorit.

Nëse personi, që vuan dënimin me qëndrim në shtëpi, nuk respekton detyrimet e vendosura nga gjykata, Shërbimi i Provës, pasi të ketë verifikuar faktet dhe rrethanat, njofton prokurorin, i cili i kërkon gjykatës revokimin e dënimit dhe zëvendësimin me një lloj tjetër dënimi.

Neni 31/5

Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë

(Shtuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008; ndryshuar paragrafi 1 me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Kur gjykata vendos pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me vënien në provë, sipas parashikimeve të nenit 59, të Kodit Penal, i njofton menjëherë prokurorit shkurtimin e vendimit.

I dënuari i vënë në provë, gjatë kohës së provës, duhet të raportojë rregullisht te shërbimi i provës, i cili duhet të informojë rregullisht organet vendore të Policisë së Shtetit.

Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe i raporton menjëherë prokurorit, kur personi i dënuar nuk mban kontakte me këtë shërbim apo nuk përmbush detyrimin e vendosur.

Neni 31/6

Ekzekutimi i vendimit të lirimit me kusht

(Shtuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008; ndryshuar paragrafi i gjashtë dhe i shtatë dhe shtuar dy paragrafë pas paragrafit të gjashtë me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

I dënuari me burgim, në përputhje me nenin 64 të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për lirim me kusht në gjykatën e vendit të ekzekutimit të dënimit. Kërkesa shqyrtohet nga një gjyqtar, i ndryshëm nga ai që ka dhënë vendimin e dënimit me burgim.

Pas paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht, drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të personit të dënuar dhe një raport për të. Në raport përcaktohen natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, ndonjë vepër e mëparshme penale, e kryer prej tij, gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Gjykata i kërkon shërbimit të provës të paraqesë një raport për kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete, për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirit.

Kur gjykata vendos lirim me kusht të personit të dënuar, ia dërgon vendimin prokurorit të gjykatës së rrethit gjyqësor, ku do të jetojë i dënuari pas lirit dhe institucionit të ekzekutimit të vendimit penal.

Personi i liruar me kusht duhet t'i raportojë rregullisht shërbimit të provës gjatë kohës së lirit me kusht.

Kur personi i liruar me kusht kërkon të ndryshojë vendbanimin, ai duhet të njoftojë paraprakisht Shërbimin e Provës, duke paraqitur dokumentacionin përkatës që vërteton ndryshimin e vendbanimit.

Zyra vendore e Shërbimit të Provës, e cila ka mbikëqyrur deri në atë moment të dënuarin, ia përcjell praktikën e ekzekutimit për të dënuarin zyrës përkatëse vendore të Shërbimit të Provës, ku i dënuari ka vendbanimin e ri.

Shërbimi i Provës njofton në lidhje me ndryshimin e vendbanimit organet vendore të Policisë së Shtetit, si dhe prokurorin që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit.

Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të lirit me kusht dhe, kur është e nevojshme, bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ato të Policisë së Shtetit. Shërbimi i Provës detyrohet të informojë me shkrim sa më parë prokurorin kur i dënuari i vënë në provë nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës ose nuk përmbush rregullisht detyrimet e përcaktuara në vendimin e gjykatës. Shërbimi i Provës mund t'i kërkojë prokurorit ndryshimin e një ose të disa detyrimeve të personit të liruar me kusht, kur ai nuk është në gjendje t'i përmbushë ato.

KREU II/1

SHËRBIMI I PROVËS

(Shtuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008)

Neni 31/7

Shërbimi i provës

(Shtuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008; shtuar një paragraf pas paragrafit të tretë me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Shërbimi i provës është organi shtetëror, që mbikëqyr zbatimin e dënimeve alternative, paraqet informacion dhe raporte para prokurorit ose gjykatës, sipas këtij ligji dhe ndihmon në ekzekutimin e dënimit alternativ, si dhe ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social.

Organet shtetërore qendrore dhe organet e njësive të qeverisjes vendore i japin shërbimit të provës ndihmën e nevojshme për përmbushjen e detyrave ligjore. Shërbimi i provës bashkëpunon me OJF-të dhe shërbimin e ndërmjetësimit, në bazë të rregullave të hollësishme, të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë.

Shërbimi i provës ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social, duke vendosur kontakte me familjen dhe mjedisin shoqëror të të dënuarit, me organizatat jofitimprurëse dhe individët.

Shërbimi i Provës bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe

institucione të tjera të drejtësisë penale gjatë pranimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të rrezikshmërisë dhe nevojave të të dënuarve me dënime alternative me burgim.

Neni 31/8

Raporti i shërbimit të provës para vendimit

(Shtuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008; ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Shërbimi i provës, me kërkesë të prokurorit ose të gjykatës, paraqet një raport për vlerësimin e rrethanave shoqërore, për të ndihmuar marrjen e vendimeve gjatë fazës së hetimeve paraprake ose të gjykimit.

Raporti duhet të përmbajë informacion dhe të dhëna për personalitetin e shkelësit të ligjit, punësimin e mëparshëm, sjelljen e nivelin arsimor dhe faktorët që ndikojnë apo mund të ndikojnë në sjelljen e tij, me qëllim që të ndihmojë gjykatën në vlerësimin e duhur të dënimit alternativ.

Raporti mbështetet në fakte, duhet të jetë i paanshëm dhe objektiv, si dhe dërgohet brenda kohës së caktuar nga gjykata.

Raporti duhet të përmbajë edhe rekomandimin e shërbimit të provës për dënimin e përshtatshëm alternativ për personin, për integrimin e tij në shoqëri dhe parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale.

Neni 31/9

Ekzekutimi i dënimit alternativ

(Shtuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008; ndryshuar paragrafi i parë dhe shtuar katër paragrafë pas paragrafit të dytë me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Kur gjykata vendos pezullimin e vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me një dënim alternativ, i dërgon menjëherë prokurorit shkurtimin e vendimit për ekzekutimin e dënimit alternativ.

Në qoftë se personi i dënuar është i burgosur, gjykata ia dërgon një kopje të vendimit edhe institucionit të ekzekutimeve të vendimeve penale, ku mbahet i dënuari, për lirimin e tij.

Në rastin kur i dënuari nuk paraqitet të nesërmen e shpalljes së vendimit, afati i ekzekutimit të dënimit alternativ fillon në momentin e kontaktit të parë të personit të vendosur në provë me Shërbimin e Provës. Kohëzgjatja e kohës së provës përcaktohet në vendimin penal.

Në rastin kur dënimi alternativ nuk mund të ekzekutohet për shkaqe të pavarura nga vullneti i të dënuarit, Shërbimi i Provës informon pa vonesë prokurorin për pamundësinë e ekzekutimit për shkaqe objektive.

Me kërkesë të prokurorit, gjykata mund të vendosë shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të dënimit alternativ, deri në zhdukjen e pengesës objektive.

Gjykata mund të vendosë shtyrjen e ekzekutimit të dënimit alternativ edhe në rastet kur ndaj të dënuarit caktohet një masë sigurimi personal.

Shërbimi i provës mund t'i propozojë prokurorit për të ndryshuar, sipas ligjit, kushtet dhe detyrimet për të dënuarin, pasi verifikon faktet dhe rrethanat e mospërmbushjes së tyre nga i dënuari.

Në ekzekutimin e dënimit alternativ, shërbimi i provës mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve dhe të kushteve të përcaktuara në vendimin e gjykatës, asiston dhe këshillon të dënuarin në përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe jep ndihmë në integrimin social të tij.

Me kërkesë të gjykatës ose të prokurorit, shërbimi i provës përgatit një raport për zbatimin e vendimit të gjykatës dhe të programit të mbikëqyrjes.

Kur i dënuari nuk përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga gjykata, shërbimi

i provës paraqet raport para prokurorit, i cili përmban informacion për rrethanat e shkeljes, shpjegimet e dhëna nga i dënuari, vlerësimin e punonjësit të shërbimit të provës dhe propozimin, së bashku me arsyet përkatëse, për të caktuar detyrime shtesë, për të zgjatur afatin e mbikëqyrjes apo për të ndryshuar kushtet e detyrimit për ekzekutimin e dënimit.

Neni 31/10

Shqyrtimi i kërkesës për ndryshimin ose revokimin e dënimit alternativ

(Shtuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008)

Gjykata, me kërkesë të prokurorit, shqyrton shkeljen e kushteve të dënimit alternativ apo mospërmbushjen e detyrimit të dhënë dhe mund të vendosë ndryshimin ose revokimin e pjesshëm a të plotë të dënimit alternativ.

Gjatë periudhës që shqyrton masën e revokimit të dënimit alternativ, gjykata mund të pezullojë ekzekutimin e tij dhe të urdhërojë që personi i dënuar të vendoset në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale.

Kur gjykata vendos ndryshimin ose revokimin e dënimit alternativ, dënimi me burgim jepet në mungesë të dënimeve të tjera alternative të përshtatshme. Në çdo rast, gjykata merr parasysh mënyrën dhe shkallën e mospërmbushjes së detyrimeve nga i dënuari.

Gjykata, pasi dëgjon prokurorin, të dënuarin, mbrojtësin e tij dhe provat e kërkuara prej tyre, merr vendim brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së prokurorit. Vendimi i njoftohet personit të dënuar, mbrojtësit të tij, shërbimit të provës dhe prokurorit.

Ndaj vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 31/11

Përfundimi i periudhës së provës

(Shtuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008)

Kur i dënuari kryen dënimin alternativ apo përmbush detyrimin e dhënë, shërbimi i provës paraqet përpara prokurorit raportin për përfundimin e plotë të periudhës së mbikëqyrjes. Prokurori nxjerr vendim të veçantë për kryerjen e dënimit alternativ.

Gjykata mund të vendosë përfundimin para afatit të dënimit alternativ, me propozimin e prokurorit, në të cilin vërtetohet se i dënuari ka kryer detyrimet dhe vlerësohet se nuk është më e nevojshme për t'i zbatuar më tej ato, për të arritur qëllimin e dënimit alternativ. Kërkesa e prokurorit për përfundimin para afatit përmban të dhëna për precedentët penalë të të dënuarit, përshkrim të dinamikës së sjelljes së të dënuarit e progresin e arritur gjatë ekzekutimit të dënimit dhe arsyet e paraqitjes së kërkesës.

Kërkesa për përfundimin para afatit të dënimit alternativ paraqitet pasi i dënuari ka ekzekutuar më shumë se gjysmën e periudhës kohore dhe nuk paraqet rrezikshmëri për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale, rendin publik apo palët e treta.

Neni 31/12

Struktura dhe organizimi i shërbimit të provës

(Shtuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008)

Shërbimi i provës organizohet në nivel qendror dhe vendor. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në Ministrinë e Drejtësisë përbën nivelin qendror, ndërsa zyrat vendore të shërbimit të provës veprojnë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore.

Rregullat e hollësishme për organizimin, të drejtat e detyrimit dhe standardet e mbikëqyrjes përcaktohen në rregulloren e brendshme, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

KREU III EKZEKUTIMI I DËNIMEVE ME GJOBË

Neni 32 **Vënia në ekzekutim**

Ekzekutimi i një vendimi dënimi me gjobë bëhet me urdhrin e ekzekutimit të prokurorit në masën, afatet dhe mënyrën e pagimit sipas vendimit të gjykatës.

Ekzekutimi bëhet nga organi përmbarimor në territorin e të cilit ka vendbanimin i dënuari, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile për titujt ekzekutivë.

Kur i dënuari ndryshon vendbanimin, mbi njoftimin e tij, ekzekutimi i vendimit transferohet në organin përmbarimor të vendbanimit të ri.

Neni 33 **Pamundësia ose shmangia nga ekzekutimi**

Kur ekzekutimi i gjobës është i pamundur tërësisht ose pjesërisht, me njoftim të organit përmbarimor, prokurori i paraqet kërkesë gjykatës së vendit të ekzekutimit për konvertimin e gjobës, duke zbatuar rregullat e nenit 467 të Kodit të Procedurës Penale.

Kur nuk respektohen afatet e pagimit ose nuk njoftohet ndryshimi i vendbanimit, me kërkesë të prokurorit, gjykata e vendit të ekzekutimit vendos zëvendësimin e gjobës së mbetur me burgim sipas Kodit Penal.

KREU IV EKZEKUTIMI I DËNIMEVE PLOTËSUESE

Neni 34 **Vënia në ekzekutim** *(ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)*

Kur është dhënë dënimi kryesor me burgim, bashkë me të ekzekutohen edhe dënimet plotësuese të parashikuara nga pikat 2, 4 dhe 9 të nenit 30 të Kodit Penal.

Dënimet e tjera plotësuese ekzekutohen pas vuajtjes së dënimit kryesor, kur nga gjykata nuk është vendosur ndryshe.

Urdhrin e ekzekutimit, prokurori ia dërgon organit kompetent për kryerjen e veprimit që përmban dënimi plotësues.

Neni 35 **Përgjegjësia për veprime në kundërshtim me vendimin**

I dënuari ose organi i ngarkuar me ekzekutimin e dënimit plotësues kur kryejnë veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës, kanë përgjegjësi sipas nenit 321 të Kodit Penal.

Organet shtetërore, të cilat konstatojnë veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës, detyrohen të njoftojnë prokurorin, i cili edhe kryesisht procedon sipas ligjit.

Neni 36 **Heqja e dekoratave ose titullit**

Për vendimet që përmbajnë dënimin plotësues parashikuar nga pika 4 e nenit 30 të Kodit Penal, prokurori i dërgon urdhrin e ekzekutimit organit që ka akorduar dekoratën apo titullin

dhe kopje të vendimit të dënimit, duke i kërkuar të bëhen shënimet përkatëse tërheqja e shenjës dalluese dhe e dëshmisë origjinale nga i dënuari.

Kur për shkak të dekoratës apo të titullit ka privilegje apo përfitime, organi i mësipërm njofton organet përkatëse për ndërprerjen e tyre.

Neni 37

Ndalimi për të drejtuar automjetet

Organet e Policisë së Shtetit, në bazë të urdhrin të prokurorit bëjnë shënimet në regjistrat përkatës dhe i tërheqin të dënuarit dëshminë për atë kohë sa ka vendosur gjykata.

Policia e Shtetit e kthen dëshminë e aftësisë edhe para afatit të caktuar me urdhrin të prokurorit ose të organeve të tjera kompetente, kur parashikohet me ligj të veçantë.

Neni 38

Ndalimi i qëndrimit

Mbi urdhrin e ekzekutimit, Policia e Shtetit merr masa për të mos lejuar hyrjen e të dënuarit në njësitë administrative të caktuara dhe largimin e tij kur gjendet në to.

Në zbatimin e kësaj mase organet e policisë së shtetit në territoret përkatëse kryejnë veprime sikurse për kërkimin e personit, për atë sa nuk vijnë në kundërshtim me këtë ligj.

Kur personi i dënuar në kohën e ekzekutimit të vendimit është prind i vetëm me fëmijë të mitur dhe kur i dënuari nuk ka mundësi ta mbajë, nëpërmjet këshillit të kujdestarisë bëhet sistemimi i fëmijës.

Neni 39

Nxjerrja jashtë territorit

(ndryshuar paragrafi i dytë dhe shtuar një paragraf me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Dënimi i nxjerrjes jashtë territorit ekzekutohet nga vetë i dënuari brenda afatit të caktuar nga prokurori në urdhrin e ekzekutimit, në të kundërt zbatohen rregullat e ekzekutimit të detyruar.

Kur i dënuari shtetas i huaj ose person pa shtetësi ka pasur dënim kryesor burgimin, nxjerrja e tij jashtë territorit ekzekutohet nga Policia e Burgjeve dhe autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin në Policinë e Shtetit, të cilat menjëherë pas përfundimit të vuajtjes së dënimit kryesor, marrin masat përkatëse për nxjerrjen e të dënuarit jashtë territorit.

Kur zbatimi i masës së parashikuar në paragrafin e dytë, të këtij neni, nuk mund të realizohet menjëherë, organet përgjegjëse veprojnë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për të huajt.

Kur i dënuari nuk mund të kthehet në vendin, shtetas i të cilit është ose në një shtet tjetër, prokurori është i detyruar të sigurojë hyrjen në vendin e tij ose vizë, në të kundërtën paraqet kërkesë për ndryshimin e dënimit plotësues.

Në çdo rast për të dënuarit- shtetas të huaj prokurori nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme për urdhrin e ekzekutimit të këtij dënimi.

Neni 40

Ekzekutimi i dënimit me konfiskim

Vendimet penale që parashikojnë konfiskimin e mjeteve dhe përfitimeve të rrjedhura nga vepra penale, zbatohen nga organi përmbarimor kompetent, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile për ekzekutimin e detyrueshëm.

Organi përmbartimor në ekzekutim të vendimit nuk kufizohet vetëm në objektet e sekuestruara, por në të gjithë objektet dhe përfitimet që përcaktohen shprehimisht në vendimin e gjykatës.

Neni 41

Ndalimi i ushtrimit të detyrave shtetërore

Dënimi plotësues i ndalimit për të ushtruar detyra shtetërore ose në shërbim publik, zbatohet nga organi që e ka emëruar ose që ka lidhur marrëdhëniet e punës i dënuari, me largimin nga detyra përkatëse, duke respektuar rregullat ligjore përkatëse.

Kur marrëdhënia e punës është krijuar me anë zgjedhjeje, vendimi ekzekutohet nga organi kompetent.

Kur detyra në shërbim publik kushtëzohet me licencim, vendimi ekzekutohet nga organi që jep licencën.

Neni 42

Ndalimi i ushtrimit të një veprimtarie apo mjeshtërie

Organi që është kompetent për dhënien e lejes apo të autorizimit për ushtrimin e një veprimtarie apo mjeshtërie të caktuar, është i detyruar mbi bazën e urdhrin të prokurorit t'i heqë personit të dënuar dokumentin për kohën e caktuar në vendimin e gjykatës dhe njofton organin kompetent financiar.

Neni 43

Heqja e të drejtës për ushtrimin e detyrave drejtuese

Heqja e të drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë, bëhet nga organi që e ka një të drejtë të tillë sipas statutit ose rregullave përkatëse dhe njofton organin kompetent financiar.

Neni 44

Detyrimi për publikimin e vendimit

Në ekzekutim të këtij vendimi, prokurori i vë në dispozicion të dënuarit tekstin e plotë ose ekstratin e tij sipas përcaktimit të gjykatës.

I dënuari detyrohet të bëjë publikimin, me shpenzimet e tij, në një ose disa organe të medias, në kohën dhe mënyrën e caktuar në vendim dhe, kur ka pengesa, kërkon ndërhyrjen e prokurorit.

Kur organi i përcaktuar shprehimisht nga gjykata, kundërshton për shkaqe të arsyeshme ose publikimi në atë organ është i pamundur, prokurori i kërkon gjykatës ndryshimin e vendimit. Në të kundërtën prokurori përcakton vetë mënyrën e publikimit.

KREU V

EKZEKUTIMI I URDHËRIMEVE TË TJERA

Neni 45

Ekzekutimi i masës mjekësore

Masa mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohet në institucionin mjekësor të specializuar sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë mbi kërkesën e prokurorit. Me urdhrin e ekzekutimit, dërgimi në institucion i të dënuarit të arrestuar bëhet nga organi ku është mbajtur i dënuari, dhe kur është i lirë, nga Policia e Shtetit.

Masa mjekësore me mjekim të detyruar ambulator ekzekutohet në institucionet mjekësore të vendbanimit të të detyruarit. Kur në to nuk ka specialistë përkatës, shoqërohet në çdo rast nga këto institucione në rrethin më të afërt ku ka të tillë.

Kur në ekzekutim të kësaj mase sillen pengesa nga i detyruari, prokurori urdhëron ekzekutimin e detyruar nga Policia e Shtetit dhe, kur është vendi, i paraqet kërkesë gjykatës për ndryshimin e masës në mjekim të detyruar në një institucion mjekësor.

Neni 46

Ekzekutimi i masave edukuese

(ndryshuar me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Masa edukuese ekzekutohet në institucionet e posaçme të edukimit të të miturve. Ekzekutimi i këtyre masave bëhet në mënyrë vullnetare nga prindi ose përfaqësuesi ligjor/procedural, bazuar në urdhrin e ekzekutimit të prokurorit, në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Kur nuk bëhet ekzekutim vullnetar në datën e caktuar ose kur i mituri nuk ka prindër apo përfaqësues ligjor/procedural, ekzekutimi i masave edukuese bëhet nga punonjësi i Policisë së Shtetit, i specializuar dhe i trajnuar në drejtësinë penale për të mitur.

Punonjësi i Policisë së Shtetit merr masat përkatëse për ekzekutimin e vendimit, me të cilin është marrë një masë edukuese ndaj të miturit, duke e shoqëruar atë së bashku me një punonjës social ose psikolog të specializuar në drejtësinë penale për të mitur.

Neni 47

Masat penale ndaj personave juridikë

Kur gjykata ka vendosur masë penale për personat juridikë, prokurori i dërgon urdhrin e ekzekutimit organit përmbarimor të vendit ku ka qendrën personi juridik, i cili vepron sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile për ekzekutimin e detyrueshëm.

Për vënien në ekzekutim të vendimit organi përmbarimor njofton organin financiar, ku është regjistruar personi juridik.

KREU VI

AFATET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE

Neni 48

Afatet e veprimeve të gjykatës

(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Veprimet për vënien në ekzekutim të vendimit penal duhet të kryhen menjëherë, sapo të jenë plotësuar kushtet ligjore, por jo më vonë se brenda këtyre afateve:

1. Për vendimet që përmbajnë dënim me burgim dhe që nuk janë ankuar ose nuk është ushtruar rekurs, gjykata i dërgon prokurorit kopjen e vendimit brenda 24 orëve nga e nesërmja e ditës që vendimi merr formë të prerë.

2. Për vendimet që përmbajnë dënime me burgim, për të cilin është ushtruar ankim ose rekurs, vendimi i dërgohet respektivisht prokurorit pranë gjykatës së shkallës së parë apo prokurorit të apelit brenda 24 orëve nga data e depozitimit të tij në sekretari.

3. Vendimet që përmbajnë dënime penale ose urdhërime të tjera, i dërgohen prokurorit nga gjykata jo më vonë se 3 ditë nga marrja formë të prerë.

4. Kur është vendosur pezullimi ose shtyrja e ekzekutimit të vendimit, afatet e mësipërme fillojnë nga data që gjykata anulon pezullimin ose plotësohet afati i shtyrjes.

Neni 49

Afatet e veprimeve të prokurorit

(shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 80/2018, datë 15.11.2018)

Prokurori kryen veprimet paraprake dhe lëshon urdhrin e ekzekutimit:

1. për dënimet me burgim ose mjekim të detyrueshëm në institucionet mjekësore, me të paraburgosur, menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 48 orë nga ardhja e vendimit penal;

1/1. Për vendimet që parashikojnë lirimin e menjëhershëm të të dënuarit dhe zbatimin e një dënimi alternativ, menjëherë pas marrjes së shkurtimit të vendimit dhe në çdo rast jo më vonë se 24 orë.

2. për dënimet me burgim për të gjykuarit në gjendje të lirë, jo më vonë se 72 orë nga ardhja e vendimit;

3. për dënimet me gjobë, kur është dhënë vetëm dënim plotësues dhe për urdhërimet e tjera të gjykatës, brenda 5 ditëve nga ardhja e vendimit;

4. për dënimet plotësuese që ekzekutohen njëkohësisht me dënimin kryesor, urdhri i ekzekutimit është i njëkohshëm;

5. për dënimet plotësuese të tjera urdhri i ekzekutimit nxirret pas përfundimit të dënimit kryesor.

Neni 50

Afatet e fillimit të ekzekutimit

Urdhrat e ekzekutimit për vendime penale me burgim dhe masë mjekësore me mjekim të detyrueshëm për personat e paraburgosur ekzekutohen brenda 48 orëve nga marrja e tij.

Për urdhrat e ekzekutimit me dënime ose urdhërime të tjera ekzekutimi duhet të fillojë menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga marrja e tij.

Neni 51

Shtyrja e afateve

Kur pas lëshimit të urdhrin të ekzekutimit gjykata vendos pezullimin ose shtyrjen e ekzekutimit, afatet e mësipërme fillojnë nga data e anulimit të pezullimit, plotësimit të periudhës së shtyrjes ose ndërprerjes së tyre me vendim të gjykatës.

PJESA IV

KONTROLI NË EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE

KREU I

KONTROLI I GJYKATËS DHE I PROKURORIT

Neni 52

Kompetenca

Kontrolli procedural për ekzekutimin e vendimeve bëhet nga prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin. Kur ekzekutimi i vendimit bëhet në një rreth tjetër, autorizohet prej tij prokurori përkatës.

Gjykata që ka dhënë vendimin ose gjykata e vendit ku ekzekutohet dënimi, për çështjet në kompetencë të saj që dalin gjatë ekzekutimit, ka të drejtë të kërkojë njoftime nga prokurori dhe organi ku ekzekutohet vendimi dhe, kur e shih me vend, kontrollon drejtpërdrejt rregullsinë e ekzekutimit.

Neni 53

Format e kontrollit të prokurorit

Prokurori realizon kontrollin nëpërmjet:

1. marrjes së njoftimit për fillimin dhe përfundimin e ekzekutimit nga organi përkatës;
2. shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të të dënuarve dhe mbrojtësit të tij;
3. kërkit të informacioneve dhe verifikimeve të drejtpërdrejta mbi dokumente ose në vendin e vuajtjes së dënimit në prani të personit zyrtar përkatës;
4. marrjes dhe verifikimit të njoftimeve për fakte dhe rrethana që ndikojnë në ekzekutimin e vendimeve;
5. marrjes së mendimit të specialistëve të fushave të ndryshme;
6. bashkëpunimit me kontrollin e brendshëm të organit ku ekzekutohet vendimi ose të institucioneve shtetërore të kontrollit administrativ.

Neni 54

Dokumentimi i verifikimeve

Për verifikimet që bëhen në vende ku ekzekutohet vendimi ose në vende të tjera, prokurori mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga personi zyrtar i pranishëm, i cili ka të drejtë të pasqyrojë pretendimet e tij.

Për verifikimet mbi ankesën e të dënuarit apo mbrojtësit të tij, ky i fundit duhet të jetë i pranishëm kur e kërkon.

Kur prokurori e shih të nevojshme, tërheq dokumente, sende ose objekte që konfirmojnë rezultatin e verifikimit, duke i pasqyruar në procesverbal, kopje e të cilit u lihet të interesuarve.

Neni 55

Veprimet e prokurorit për konstatimet

Prokurori i paraqet kërkesë gjykatës për rivendosjen e rregullit të shkelur ose njohjen e së drejtës të të dënuarit për rastet në kompetencë të saj.

Në rastet e tjera prokurori ndërhyr në organet e ngarkuara me ekzekutimin e vendimit ose në organe të tjera kompetente, për rivendosjen e ligjit ose të drejtës së cenuar, duke caktuar dhe afatet përkatëse.

Kur nuk ka pengesë ligjore, prokurori urdhëron rivendosjen e menjëhershme të ligjit dhe të së drejtës së shkelur.

Neni 56

Përgjegjësia për shkeljet e konstatuara

Kur është rasti, prokurori paraqet kërkesë në organin kompetent për vënien para përgjegjësisë disiplinore e administrative ose të zhdëmtimit ndaj personave që kanë lejuar ose kanë kryer shkelje.

Kërkesa shqyrtohet detyrimisht nga organi kompetent dhe përfundimi i njoftohet prokurorit.

KREU II KONTROLLE TË TJERA

Neni 57

Kontrolli i brendshëm

Organet dhe institucionet ku ekzekutohet vendimi ose që janë të ngarkuara me mbikëqyrjen e ekzekutimit, si dhe organet eprorë të tyre në kuadrin e kontrollit të brendshëm, të bëjnë verifikimet përkatëse.

Për konstatimet, kur janë kompetente, marrin masa përkatëse, në të kundërtën kërkojnë ndërhyrjen e prokurorit dhe, kur është rasti, nëpërmjet tij kërkojnë shqyrtimin e çështjes nga gjykata.

Neni 58

Të drejta të organeve të tjera

Në vendet e vuajtjes së dënimeve, mund të kërkojnë informacione dhe sqarime edhe organe të tjera shtetërore dhe organizatat joqeveritare lidhur me rregullsinë e ekzekutimit të vendimit dhe respektimin e të drejtave të të dënuarit, duke rekomanduar marrjen e masave përkatëse dhe kur e shohin me vend, të kërkojnë ndërhyrjen e prokurorit.

Nga rregulli i mësipërm bëjnë përjashtim institucionet e vuajtjes së dënimit me burgim, për të cilat zbatohen kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë.

KREU III KOMISIONI MBIKËQYRËS I EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE ME BURGIM

Neni 59

Funksionet

Komisioni mbikëqyrës i ekzekutimit të vendimeve penale që përmbajnë dënime me burgim është organ këshillimor për zbatimin e ligjit në ekzekutimin e dënimeve me burgim dhe mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.

Komisioni mbikëqyrës ngrihet pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe e shtrin veprimtarinë në të gjithë vendin dhe e ka qendrën në Tiranë.

Neni 60

Përbërja

Komisioni përbëhet nga 9 anëtarë me votë të barabartë, që caktohen një herë në katër vjet pa të drejtë ricaktimi.

Mbledhja e komisionit është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve.

Kryetari i komisionit dhe zëvendësi zgjidhen nga mbledhja e anëtarëve.

Neni 61

Caktimi i anëtarëve

(Ndryshuar me ligjin nr.10 024, datë 27.11.2008)

Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri caktojnë si anëtarë nga një person që nuk ka funksione publike.

Ministrat që mbulojnë shëndetësinë, ushqimin, ndërtimin dhe kulturën, caktojnë nga një anëtar prej punonjësve të tyre, me kusht që të jenë specialistë në profilet përkatëse.

Ministri i Drejtësisë cakton një anëtar që nuk ka funksione publike, por që ka kushte për të qenë gjyqtar.

Një anëtar caktohet nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Neni 62

Statusi i anëtarëve

Anëtarët e komisionit gjatë ushtrimit të detyrave kanë atributet dhe përgjegjësitë ligjore të nëpunësit publik. Publikimi i të dhënave nga anëtarët bëhet me leje të Ministrit të Drejtësisë. Në çdo rast zbatohen rregullat për ruajtjen e sekretit shtetëror.

Anëtarët e komisionit rezervojnë të drejtën të japin informacione për veprimtarinë dhe konstatimet në organin që i ka caktuar.

Neni 63

Veprimet e komisionit

Komisioni mblidhet rregullisht një herë në tre muaj dhe në raste të veçanta me kërkesë të kryetarit edhe më parë.

Mbi bazën e ankesave ose njoftimeve të paraqitura, komisioni ose anëtari i autorizuar prej tij ka të drejtë të kryejë verifikime edhe pa paralajmërim në institucionet e dënimit, të marrë takim në çdo kohë me të burgosur të veçantë, të kërkojë sqarime dhe të këqyrë dokumentet dhe mjediset, si dhe të bëjë verifikimet e tjera të nevojshme.

Veprimet kryhen në prani të drejtorit të institucionit ose të ngarkuarit prej tij, me përjashtim të takimit me të burgosurin, që mund të bëhet edhe pa praninë e tyre.

Komisioni rekomandon marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e ligjit apo të së drejtës së shkelur dhe i parashtron Ministrit të Drejtësisë konstatimet, duke i kërkuar marrjen e masave përkatëse. Ministri i Drejtësisë duhet të kthejë përgjigje për masat e marra brenda 30 ditëve.

Kur marrja e masave është në kompetencë të prokurorit dhe gjykatës, Ministri i Drejtësisë i paraqet materialet prokurorit kompetent.

Kur nga konstatimet çmohet se ka vend për ndryshime, shtesa ose për akte të reja ligjore e nënligjore, komisioni bën propozime në organet kompetente.

Neni 64

Shpërblimi dhe shpenzimet

Anëtarët e komisionit shpërblehen sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ministri i Drejtësisë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve krijon kushtet e nevojshme për veprimtarinë e komisionit.

DISPOZITA TRANSITORE DHE TË FUNDIT

Neni 65

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen Prokurori i Përgjithshëm, e Drejtësisë dhe Ministriapërgjegjëse për rendin publik.

Mbi propozimin e tyre dhe në zbatim të këtij ligji Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

Ministri i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministri i Brendshëm marrin masat dhe nxjerrin aktet e nevojshme nënligjore për të siguruar zbatimin e këtij ligji.

Deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore, aktet ekzistuese mbeten në fuqi për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 66

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2079, datë 8.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani